



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1179/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Sejdi Dulla, kandidat për anëtar të kuvendit komunal nga radhët e PDK-së në Lipjan, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të manipulimit me vota, për Zgjedhjet Lokale në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Sejdi Dulla kandidat për anëtar të kuvendit komunal në Lipjan, nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK).

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 03.12.2013 në ora 14:56 nga Sejdi Dulla kandidat për anëtar të kuvendit komunal nga radhët e PDK-së, ku ka pretenduar se në vendvotimin në Krojmir dhe Magure janë bërë shkelje të cilat më kanë dëmtuar në vota në këto dy qendra të votimit, thuhet në pretendimet e ankuesit. Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesën gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i, konstatoi nga shkresat e lëndës se pretendimet ankimore të kandidatit për anëtar të kuvendit komunal Sejdi Dulla janë të pa argumentuara në fakte dhe dëshmi konkrete pasi që ankesës në fjalë nuk i ka bashkangjitur asnjë dëshmi bindëse, për tu vërtetuar për shkeljen e supozuar andaj ankesa vlerësohet si e pa bazë, duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 1179/2013 më datën 06.12.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Ferit Osmanit**



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.